



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.216/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj, kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.01.2025, merr këtë:

#### V E N D I M

Refuzohen të pabazuara ankesat Anr.216/2025, Anr.217/2025 të datës 27.01.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Subjekti Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës - IRDK, paraqitur kundër Partisë Liberale Egjiptiane - PLE, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

#### A r s y e t i m

Me datën 27.01.2025 PZAP-i, ka pranuar Ankesat Anr.216/2025, Anr.217/2025 nga Subjekti Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës-IRDK, me seli në Pejë kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane-PLË me seli në Klinë. Në ankesën Anr.216/2025 paraqitur nga Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës-IRDK kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane-PLE theksohet se PLE më datë 26.01.2025, në Komunën e Klinës, përkatësisht shtëpinë e kulturës “Jehona e Dukagjinit”, ka mbajtur tubim zgjedhor me qytetar të Klinës me fshatra. Gjate këtij tubimi, përkatësisht intervalit kohor mes orës 15:00 dhe 16:00, në mesin e qytetarëve prezentë në tubim ka pasur edhe fëmije qartazi nën moshën 15 vjeçare. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotot dhe videot në CD nga tubimi në fjalë.

Në ankesën Anr.217 IRDK ka theksuar se PLE me datë: 25.01.2025, në Komunën e Obiliqit, përkatësisht shkollën “Pandeli Sotiri”, Plemetin ka mbajtur tubim zgjedhor me qytetarët e

Obiliqit me fshatra. Gjate këtij tubimi, përkatësisht intervalit kohor mes orës 15:00 dhe 16:00, në mesin e qytetarëve prezentë në tubim ka pasur edhe fëmijë qartazi nën moshën 15 vjeçare.

Parashtruesi i ankesës si prova ka bashkangjitur fotot dhe videot në CD nga tubimi në fjalë. Parashtruesi i ankesave ka theksuar se PLE më këto tubime përkatësisht fushata zgjedhore ka shkelur nenin 5, paragrafi 3, të Rregullores Zgjedhore nr.07/2025-Fusahta e Zgjedhjeve, Monitorimi i Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimi Financiar, duke angazhuar persona nën moshën 15.

Më datë 27.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Prishtinë, për ankesat e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me 28.01.2025 në ora 15:00.

Në Përgjigjen në ankesën Anr.216/2025 subjekti politik PLE ka theksuar se e kundërshton në tërësi ankesën për faktin se në fotografitë e bashkangjitura dhe në video incizim shihet një person që nuk është fëmije por që fatkeqësisht është i pazhvilluar me trup dhe është me nevoja të veçanta dhe në asnjë mënyre nuk qëndron pretendimi i ngritur nga IRDK se i njëjti është i moshës nën 15, por i njëjti është 22 vjeçar. Si provë parashtruesi i përgjigjes në ankesë ka bashkangjitur: Letërnjoftimin e tij, Vendimin nga Departamenti i Pensioneve dhe një fotografi dërguar nga ai personalisht dhe prindi i tij. Në përgjigjen në ankesën Anr.217/2025, subjekti politik PLE ka theksuar se në fotografitë e bashkangjitura dhe në video incizim ku pretendohet se shihen disa fëmije, PLE ka identifikuar personat prezent në tubim elektoral dhe asnjëri prej tyre nuk ka qenë fëmije i mitur por se të njëjtit janë të moshës madhore por meqenëse janë veshur me jakne dhe kapela kanë lenë përshtypjen se janë fëmije të mitur apo ndoshta qëllimi i IRDK është paraqitja e ankesave të pabazuara për të vështirësuar gjendjen financiare të PLE, pasi që e njëjta nuk merr buxhet të shtetit sikurse partitë parlamentare. Si provë parashtruesi i përgjigjes në ankesë ka bashkangjitur: Letërnjoftimin e personave dhe fotografitë ku shihet dhe ku vërtetohet se janë të moshës madhore.

PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë të paraqitur nga subjekti Partia Liberale Egjiptiane - PLE, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik IRDK, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar neni 5 paragrafi 3 parasheh se *“Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatën zgjedhore. Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore, nuk mund të behet pa prezencën apo pëlqimin e prindërve.”*, me arsyetimin se bazuar në përgjigjen në ankesën Anr.216/2025 rezulton se personi në fjalë nuk është fëmije fakt ky që e argumentojnë edhe provat e bashkangjitura si *Letërnjoftimi personal i Benak Itaj i cili shihet se ka lindur me 10.03.2003 që rezulton se nuk është fëmije i moshës së mitur, Vendimi i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve – Zyra Pensionale në Pejë me të cilin Miratohet kërkesa e z/nj Benak Itaj, për njohjen e të drejtës në pension të personave me*

*paaftësi të përhershme* e që rezulton se i njëjti është me *paaftësi të përhershme* po ashtu bazuar edhe në përgjigjen në ankesën e Anr.217.2025 nga provat e bashkangjitura letërnjoftimet e pjesëmarrësve në tubimin e PLE, në Obiliq rezulton se të njëjtit janë persona të moshës madhore.

Parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë, ka vërtetuar se në këtë rast nuk kemi shkelje të rregullave zgjedhore dhe shkelje të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkuara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.216/2025 datë 29.01.2025

Kryesues i Panelit  
Skender Coci



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.